



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr. 04-G10/01-26363/19

Datë, 16.08.2019

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e Dhjetë (10) në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe Shkollën Profesionale “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik për vitin shkollor 2019/2020 – Afati i Gushtit

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10, në gjimnaz dhe në shkollë profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10 në gjimnaz dhe shkollën profesionale duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Ekstrakti i lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2019/20, bëhet më datën 19,20 dhe 21 gusht 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet shpallen në shkollat përkatëse me datën 23.08.2019, ndërsa kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 26.08.2019. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë Drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10 duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"- KAÇANIK

DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr.i nx të planifikuar	Nr. i nx të regj/ Qershor	Vende të lira/ Gusht
ELEKTRO TEKNIKË	- Teknik i telekomunikacionit	1	32	1	31
		1	32	6	26
	- Teknik i informatikës	1	24	8	16
	- Instalues elektrik				
EKONOMI	- Kontabilitet	1	32	8	24
	- Asistent i marketingut	1	32	21	11
	- Tregti me shumicë dhe pakicë	1	32	6	26
		1	32	1	31
	- Shpedicion dhe logjistikë				

MAKINERI	- Instalues i ngrohjes qendrore	1	24	17	7
		1	24	2	22
	- Instalues i ujësjetës dhe kanalizimit	1	24	0	24
	- Saldator	1	24	8	16
	- Automekanik	1	32	1	31
	- Operator prodhime				
Gjithsej		12	344	79	265

Gjimnazi “ Skënderbeu” – KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.i nx të planifikuar	Nr i nx të regji/ Qershor	Vende të lira/Gusht
1.	Shkenca Natyrore	4	128	93	35
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	4	128	90	38
Gjithsej		8	256	183	73

Drejtori i DAK
z. Zahir Doda

